LIGJ
Nr.8384, datë 29.7.1998

PËR SHTIMIN E NJË DISPOZITE TRANZITORE NË LIGJIN NR.8269, DATË 23.12.1997 "PËR BANKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh, anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", pas nenit 76 shtohet një nen 76/1 me këtë përmbajtje:

"Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Bankës së Shqipërisë të cilët kanë qënë propozuar nga Kuvendi Popullor, Këshilli i Ministrave, Ministri i Financave dhe Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqiperisë, të zgjedhur dhe në emëruar në bazë të ligjit nr.8230, datë 6.8.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" qëndrojnë në këtë funksion dëri në mbarim të afatit të tyre.

Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që largohen para mbarimit të mandatit për shkaqe të parashikuara në këtë ligj dhe sipas ligjit nr.8230, datë 6.8.1997 propozoheshin nga Presidenti i Republikës dhe Governatori i Bankës së Shqipërisë, bëhet me propozim të Kuvendit Popullor. Ndërsa anëtari që propozohej nga Ministri i Financave propozohet nga Këshilli i Ministrave.

Zgjedhja dhe emërimi dy anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës për të plotësuar vendet e reja, që u krijuan për shkak të shtimit të numurit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë sipas këtij ligji, bëhet nga Kuvendi Popullor.

Guvernatori, zëvendësguvernatori dhe sekretari i përgjithshëm të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryejnë funksionet (sekretari i përgjithshëm si zëvendësgovernator i dytë) deri në mbarimin e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen sipas dispozitave të këtij ligji".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2182, datë 11.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mejdani